




# Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



**Drejtoria për Arsim**  
Odeljenje za Obrazovanje  
Department for Education

## **Informatë e DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të Vitit Shkollor 2025-2026**

### **Shtator 2025-Dhjetor-2025**

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025 në kuadër të DKA-së u realizuan punë dhe aktivitete, të cilat ishin të parapara të zhvilloheshin sipas Planit Vjetor të Punës për këtë vit. Këto punë dhe aktivitete të zhvilluara po i paraqesim të shkruara sipas dy periudhave tremujore, siç vijon:

#### **Tremujori i tretë**

Bazuar në obligimet e DKA-së që dalin nga Ligji Nr. 04/L-032, për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Ligjit Nr.03/L-068, për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Rregulloreve Komunale për organizimin e punës dhe mësimin në SHFMU-të dhe SHML-të, e komunës së Rahovecit, DKA ka marrë të gjitha veprimet e nevojshme për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor 2025/26.

Në këtë drejtim fokusi i DKA-së ka qenë:

- Përgatitja infrastrukturore e objekteve shkollore
- Regjistrimi nxënësve në klasat e I-ra të arsimit fillor dhe atyre të X-ta në Arsimin e Mesëm të Lartë si dhe në IAAP.
- Plotësimi i normave ekzistuese me personel të kualifikuar.
- **Përgatitja infrastrukturore e objekteve shkollore**

Në kuadër të përgatitjeve të objekteve shkollore për fillimin e vitit të ri mësimor DKA ka angazhuar të gjithë potencialin e vet menagjerial dhe mirëmbajtës për rregullimin e hapsirave të jashtme dhe të brendshme të shkollave. Kështuqë me 1 Shtator të gjitha objektet shkollore kanë qenë të gatshme për fillimin e mësimin në vitin e ri shkollor, bazuar në kapacitetet ekzistuese të shkollave.

- **Regjistrimi nxënësve në klasat e I-ra të arsimit fillor dhe atyre të X-ta në arsimin e Mesëm të Lartë si dhë në IAAP.**

1. Regjistrimin e fëmijëve në klasa të para për vitin shkollor 2025/2026

Në komunën tonë për këtë vit shkollor në klasat e para është planifikuar që të regjistrohen 471 nxënës të shpërndarë në 40 paralele Tabela:

Nr. i nxënësve	Nr. i paraleleve	Mesatarja e nxënësve në paralele	Vërejtje
471	40	11.77	Janë të llogaritur edhe nxënësit serb

2. Regjistrimin e nxënësve në klasat e dhjeta të arsimit të mesëm të lartë për vitin shkollorë 2025/26.

2.1. Gjimnazi “Xhelel Hajda-Toni”- Rahovec

NR.	Drejtimi-Profil	Të regjistruar	
		Paralele	Nxënës
1.	Shkencat natyrore	5	90
2.	Shkencat shoqërore	1	20
	Gjithsejtë	6	110

2.2. Shkolla e Mesme Profesionale “Selajdim Mullaabazi-Mici”-Rahovec

Nr	Drejtimi-Profil	Të regjistruar	
		Paralele	Nxënës
1.	EKONOMI		
	Kontabilist	1	16
2.	JURIDIK		
	Asistent juridiku	1	17
	Asistent i administratës	1	17
3.	MAKINERI		
	Insalues i ngrohjes dhe klimatizimit	1	19
4.	ELEKTROTEKNIKË		
	Informatikë	1	16
5.	SHËNDETËSI		
	Bashkëpunëtorë profesional i infermierisë	1	22
	Teknik i Farmacisë	1	16
	Gjithsejtë:	7	123

2.3. Shkolla e Mesme e Lartë “ Ukshin Hoti” në Krushë e Madhe

NR.	Drejtimi-Profil	Të regjistruar	
		Paralele	Nxënës
1.	Shkencat Natyrore	1	13
2.	Shoqëror Gjuhësor	1	9
3.	Ekonomi-Kontabilitet	1	9
	Gjithsejtë:	3	31

#### 2.4. Shkolla e Mesme e Lartë "12 Maji" në Ratkoc

NR.	Drejtimi-Profil	Të regjistruar	
		Paralele	Nxënës
1.	Shkencat natyrore	3	33
2.	Shoqëror gjuhësor	2	24
3.	Ekonomi-Kontabilitet	1	10
Gjithsejtë:		6	67

#### 3. Publikimi i konkursit dhe pranimi i kuadrit arsimor për vitin shkollorë 2025/2026.

- Kopjet e konkurseve të publikuara për pranimin e kuadrit arsimor për vitin shkollorë 2025/26 mund ti gjeni ne ëbfaqen e Komunës së Rahovecit si dhe rezultatet e rekrutimit dhe listat e mësimdhënësve të pranuar në këto konkurse.

#### 4. Përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2025/2026.

Komuna	Numri i institucioneve arsimore	Numri i shkollave-institucioneve arsimore të përgatitura për fillimin e vitit shkollorë	Numri i shkollave-institucioneve arsimore që nuk janë të përgatitura për fillimin e vitit shkollorë	Emrat e shkollave-institucioneve arsimore që nuk janë të përgatitura për fillimin e vitit shkollorë
Rahovec	32	32	0	0

Sqarim:

Të dhënat për nxënësit e arsimit fillor 0-9 janë relevante por mund të ndryshojnë deri në raportin përfundimtar të shkollave në SMIA të cilat korespondojnë më datën 20.09.2025.

### **Tremujori i katërt**

- DKA ka pranuar një donacion nga Kompania SUPER VIVA, e cila ka dhuruar printer për të gjitha shkollat e komunës. Pajisjet janë pranuar dhe shpërndarë tek të gjitha shkollat sipas listës përkatëse.
- DKA ka realizuar një sërë aktivitete të përgatitore në kuadër të mbështetjes dhe organizimit të konkursit të poezisë për **Çmimin “Xhevdet Bajra”**, një iniciativë kulturore e rëndësishme që synon promovimin e krijimtarisë letrare tek të rinjtë dhe nderimin e veprës së poetit Xhevdet Bajra – Fardi nga Anadrini.
- Më datë 30.10.2025 ka filluar dita e parë e Trajnimit të Mësimdhënësve për Zbatimin në Praktikë të KKK-së.
- Që nga fillimi i muajit nëntor së bashku me stafin kemi zhvilluar vizita zyrtare në një numër të konsiderueshëm të institucioneve edukativo-arsimore. Gjatë muajit dhjetor nën organizimin e DKA-Së është mbajtur takim pune me zyrtaret e MASHTI-t dhe me një numër të konsiderueshëm të mësimdhënësve të programit fillor nga klasa 1-5 ku janë diskutuar problematikat e furnizimit dhe cilësisë së teksteve shkollore në përdorim nga nxënësit e shkollave tona.
- Me datë 05.12.2025 është organizuar takim me OJQ “YMCA” dhe menagjmentin e IAAP “Selajdin Mullaabazi – Mici “rreth implementimin te projektit të UNDP-së me mësimdhënës dhe nxënës të kësaj shkolle.
- Pas përfundimit të gjysmëvjetorit të parë, të gjitha shkollat kanë raportuar në Sistemin për menaxhimin e informacionit- SMIA.
- Sipas të dhënave të regjistrimit kemi këto statistika për numër të nxënësve.

**Çerdhe dhe Parafillor-879 nxënës;**

**Klasa I-IX-5143 nxënës;**

**Klasa X-XII- 996 nxënës.**

**Totali 7018 nxënës.**

Për lëndën e Matematikës në shkollat tona mungojnë 13 mësimdhënës të kualifikuar ndërsa për lëndën e Fizikës këtë vit i kemi të mbuluara të gjitha normat.

Kjo nuk do të thotë se vitet në vazhdim nuk do të kemi vështërsi, sa u përket mungesave Pa arsyje të mësimdhënësve, DKA ka shqiptuar masa ndëshkuese për këta mësimdhënës duke u ndalur medijtjen për mungesat e bëra.

Në arsimin fillor janë 7 punëtorë me gjysmë norme , ndërsa ne arsimin e mesëm janë me gjysmë norme punojnë 3 mësimdhënës.

**Përgjigje për pyetjen e asambleistit Lirigzon Kastrati drejtuar Drejtorit të Arsimit në seancën e rregullt të kuvendit, 25.02.2026:**

**Ekzekutivi ka konstatuar se janë 186 mësimdhënës më tepër në komunën tonë.** Në shkollat e komunës sonë ka një numër mësimdhënësish me gjysmë norme, të cilët e rrisin numrin fizik të mësimdhënësve në përgjithësi, por në fakt implikimet buxhetore nuk e tregojnë të njëjtën gjë. Prandaj, mund të konstatojmë se numri 186 nuk pasqyron realisht numrin e mësimdhënësve të tepërt.

Numri i mësimdhënësve të punësuar në shkolla përcaktohet në bazë të numrit të përgjithshëm të nxënësve. P.sh ekziston mesatarja e numrit të nxënësve për një mësimdhënës dhe kështu e gjejme numrin e saktë të mësimdhënësve që duhet të jenë të punësuar në shkollat tona. Ndërsa sa i përket konkurseve të shpallura nga DKA, ato kanë një specifikë të vecantë sepse kanë të bëjnë me zëvendësim të mësimdhënësëve të cilët shkojnë në pushim të lindjes, janë në pushim mjekësor ose pushim pa pagesë.

**Në pyetjen, ku janë mungesat e kuadrit profesional të Matematikës dhe Fizikës, ju njoftojmë se deficit të këtyre kuadrove kemi gjithandej nëpër shkollat e komunës sonë dhe këtë mungesë po e paraqesim me anë të këtyre të dhënave:**

Duke e ndjekur nga afër gjendjen në shkollat e Komunës së Rahovecit, vërej se në shumicën prej tyre, në fushën e shkencave, janë angazhuar mësimdhënës të profileve tjera të përafërta, arsimore dhe joarsimore.

Kjo gjendje ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies, ndërkohë që rezultatet nuk janë ato që synojnë shkollat tona.

Pasojat e kësaj gjendjeje do të bëhen shqetësuese nëse nuk merren masa të shpejta për ta evituar atë. Sa më gjatë të vazhdojë kjo situatë pa ndërhyrje institucionale, aq më të mëdha do të jenë dëmet dhe zbrazëtitat arsimore e edukative, të cilat do t'i bartin breza të tërë nxënësish.

Kam menduar për zgjidhje por çështja kërkon vlerësim institucional respektivisht kërkon të vlerësohet seriozisht nga MASHTi.

Po i rendis disa nga zgjidhjet afatshkurtëra dhe afatgjata të kësaj çështjeje:

Të vazhdohet angazhimi i mësimit në lëndë defecitar edhe pas pensionimit për 5 vite,

Rikthimi në universitete, i programeve të lëndëve për të cilat kemi deficit, e të cilat kanë ekzistuar më heret. Kjo vlen veçanërisht për Universitetet në Prizren dhe Gjakovë ku këto programe janë ofruar dikur dhe kanë përmbushur nevojat e sistemit arsimor. Njëkohësisht, është e nevojshme që studentët që regjistrohen në këto programe, të mbështeten me bursa, me qëllim të nxitjes së interesimit dhe sigurimit të kuadrove të reja profesionale për të ardhmen.

Të motivohen mësimit në shkencave (Matematikë-Fizikë), të rritet fondi i orëve dhe të lejohet pagesa mbi fondin 20 orë (për ata që kanë mundësi të mbajnë mbi normën adekuate 20 orë mësimore në javë)

Mësimit në lëndë defecitare do të fillojmë ti zëvendësojmë me mësues të programit fillor sepse të njëjtit gjatë studimeve kanë pasur disa provime të Matematikës dhe gjithashtu kanë dhënë provime të Pedagogjisë, Psikologjisë e Metodikës.

Këta mësimit përveç komponentës konceptuale do të zhvillojnë edhe komponentën edukative gjatë procesit të mësimit.

Muhamet Morina

Drejtor i DKA-së

